



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 5, datë 28 .02. 2013

**PËR
“DHËNIEN E TITULLIT “MIRËNJOHJE E TIRANËS” HUMORISTIT DHE
ARTISTIT TË MIRËNJOHUR TË ESTRADËS SË TIRANËS, Z. VELI RADA”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8/VII, gërma “a” dhe nenit 32, gërma “m” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin “Për dhënien e titullit “Mirënjohje e Tiranës” humoristit dhe artistit të mirënjohur të Estradës së Tiranës, z. Veli Rada, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin për dhënien e titullit “Mirënjohje e Tiranës” humoristit dhe artistit të mirënjohur të Estradës së Tiranës, z. Veli Rada, me motivacionin:

“Për kontributin e dhënë në zhvillimin e artit dhe kulturës në qytetin e Tiranës”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I
Niazi KOSOVRASTI**